



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVO



Agj.nr. _____

Prishtinë

REPUBLIKA E KOSOVËS		Date: 09.07.2015	REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS			VRHOVNI SUD KOSOVA
GJ.A-Su.A		217/2015	
Dt:		10.07.2015	
PRISHTINË - PRISHTINA			

Kolegjiumi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në Mbledhjen e Përgjithshme, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 09.7.2015, miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

Gjykata themelore, duhet të vendosë lidhur me prapësimet e paraqitura kundër urdhrave përmbarimor, të nxjerra nga organet përmbaruese, në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së tij.

A r s y e t i m i

Programi i USAID për Përmbarim dhe Legjislacion Komercial në Kosovë (CLE) i është drejtuar Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës me kërkesë për dhënien e Mendimit Juridik në lidhje me shqetësimet e paraqitura, në disa raste, nga

gjykatat dhe përmbauesit privat, e që kanë të bëjnë me interpretimin e dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbaimore (LPP) Nr.04/L-139.

Sipas parashtruesit të kërkesës, dilema ekziston në përcaktimin e afateve kohore përmes të cilave gjykata duhet të vendosë lidhur me prapësimet e paraqitura kundër urdhrave përmbaimore të nxjerra nga organet përmbauese, në rastin konkret nga ana e Përmbauesve Privat, e që nuk është njëjtë e rregulluar me dispozitat e LPP-së në gjuhën shqipe dhe në atë angleze, gjë që po shkakton paqartësi dhe probleme, jo vetëm për punën normale në gjykata, por edhe të përmbauesve privat gjatë zbatimit të ligjit.

Me Ligjin për Procedurën Përmbaimore, gjegjësisht në Kreun VIII që rregullon Mjetet Juridike për goditjen e vendimeve përmbaimore, nuk ka dispozitë që i cakton afat gjykatës për të vendosur lidhur me prapësimet e paraqitura kundër vendimeve të Organit Përmbaues, derisa versioni në gjuhën angleze, përkatësisht neni 72 i Ligjit –Vendosja sipas Prapësimit, e precizon qartë afatin 15 ditor për të vendosur lidhur me prapësimin e paraqitur, *citoj nenin në origjinal*:

“Neni 72


Përgjigjja lidhur me prapësimin

1. *Në Prapësimet e paraqitura, gjykata vendos në afat prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të prapësimit”,*

Procedura përmbaimore është procedurë e natyrës urgjente, andaj me qëllim të evitimit të zvarritjeve të panevojshme dhe të paarsyeshme të përmbaimit të këtyre çështjeve, dhe me qëllim të mbrojtjes së interesave të palëve në këtë procedurë, është e nevojshme që kjo gjykatë nëpërmjet mendimit juridik të caktojë afatin kohor prej 15 ditësh, brenda të cilit gjykata themelore duhet të vendosin për prapësimet që adresohen nga palët. Gjykata e ka të qartë se versioni në gjuhën shqipe ka primatin në

relacion me gjuhët tjera, por versioni i tillë nuk ka limituar aftin e vendosjes fare, e që qartë shpie në përfundim se bëhet fjalë për lëshim teknik të ligjvënësit.

Prof. Dr. Fejzullah Hasani


Fejzullah

Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës